KËRKESË
Nr.3932/2, datë 4.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Lezhë-Shëngjin" (truall dhe arë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 586 360 (katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi